



Republika e Kosovës / Republic of Kosovo  
Komuna - Municipality  
Hani i Elezit



01/Nr. 1129/2025  
Data: 19.02.2025

### PROCESVERBAL I KUVENDIT TË KOMUNËS

Procesverbali nga mbledhja e parë -I- e Kuvendit të Komunës, mbajtur me datë 30.01.2025 me fillim pune në ora 11:00 në sallën e Kuvendit të Komunës. Të pranishëm ishin: **Sevdi Dernjani** (Nënkryetar i Komunës), **Abduraman Bushi** (Drejtor për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural), **Lindita Ballazhi** (Drejtoresh për Buxhet dhe Financa), **Natyra Kalisi** (Drejtoresh e Administratës), **Arbenita Bajramaliu** (Drejtoreshë për Kulturë, Rini dhe Sport), **Majlinda Kaloshi** (Drejtoreshë për Zhvillim Ekonomik dhe Turizëm), **Nexhmedin Daci** (Drejtor për Urbanizëm Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit), **Arsim Dernjani** (Drejtor për Shërbime Publike dhe Emergjencë), **Amir Bushi** (Udhëheqës i Qendrës për Punë Sociale), **Vjosa Rogaqi** (Zyrtare për Barazi Gjinore), **Bashkim Sopa** (Zyrtarë për Transparencë).

### RENDI I PUNËS

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.
2. Raporti financiar për vitin 2024.
3. Plani i punës së këshillave të fshatrave për vitin 2025.
4. Raporti i planit lokal të veprimit për barazi gjinore për vitin 2024.
5. Raporti i mekanizmit kundër dhunës në familje në Han të Elezit.
6. Raporti i ekipit komunal për të drejtat e fëmijëve në Han të Elezit.
7. Informatë mbi veprimtarit e subjekteve afariste për vitin 2024.
8. Të ndryshme.

**Kryesuesi** thekson:- për pikat e rendit të punës hapi diskutimin, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

U MIRATUA RENDI I PUNËS

## 1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.

**Kryesuesi** thekson:- për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

### U MIRATUAR PROCESVERBALI NGA MBLEDHJA E KALUAR

## 2. Raporti financiar për vitin 2024.

**Kryesuesi** thekson:- për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

**Lindita Ballazhi** thekson:- buxheti i komunës së Hanit të Elezit i ndarë sipas Ligjit me nr. 08/L-260 mbi ndarjet buxhetore të Republikës së Kosovës për vitin 2024 është në lartësi prej 3,349,278.00 €. Ky buxhet është ndarë sipas kategorive ekonomike si në vijim: Paga dhe shtesa 2,075,272.00 €, Mallra dhe shërbime 524,500.00 €, Shpenzimet komunale 93,500.00 €, Subvencione dhe transfero 113,000.00 €, Shpenzime kapitale 543,006.00 €, Totali i buxhetit 3,349,278.00 €. Ndërsa buxheti përfundimtar është 4,010,573.67 €, ku në këtë shumë përfshihen: 1. Mjetet e ndara nga Grantet Qeveritare në shumë prej 3,140,771.42 €, 2. Projeksioni i Të Hyrave Vetanake në shumë prej 274,376.00 €, 3. Bartja e të hyrave vetanake të pa shpenzuara nga vitet paraprake në shumë prej 133,029.70 €, 4. Mjetet e mbetura nga Donacioni i Qeverisë Japoneze për projektin “Ndërtimi aneksit për këmbësor në urën e Seçishtës” në shumë prej 15,923.01 €, 5. Donacioni nga Unioni Evropian për projektin dy vjeçar “A smart system for Early Floods Detection and Easte Monitoring in the Lepenc River Basin” në shumë prej 446,359.86 €, 6. Mjete të mbetura nga Grante të cilat janë bartur vit pas viti në vlerë prej 113.68 €. Shpenzimi i kategorisë buxhetore Paga dhe Shtesa për vitin 2024 është në shumë prej 2,141,141.42 € apo 100 % nga buxheti i alokuar për këtë kategori buxhetore. Krahasuar me vitin 2023 shpenzimi për këtë kategori përgjatë vitit 2024 është më i lartë për 153,743.10 € apo 7.74 % më shumë. Shpenzimi i kategorisë buxhetore Mallra dhe Shërbime për vitin 2024 është në shumë prej 519,794.18 € apo 85.33% nga buxheti i alokuar dhe planifikuar për këtë kategori buxhetore. Krahasuar me vitin 2023 shpenzimi për këtë kategori përgjatë vitit 2024 është më i lartë për 47,146.87 € apo 9.98 % më shumë. Shpenzimi i kategorisë buxhetore Shpenzime komunale për vitin 2024 është në shumë prej 81,219.67 € apo 86.87% nga buxheti i planifikuar për këtë kategori buxhetore. Krahasuar me vitin 2023 shpenzimi për këtë kategori përgjatë vitit 2024 është më i ulët për 7,577.89 € apo 8.53 % më pak.

Shpenzimi i kategorisë buxhetore Subvencione dhe Transfere për vitin 2024 është në shumë prej 370,958.48 € apo 99.51% nga buxheti i alokuar për këtë kategori buxhetore. Krahasuar me vitin 2023 shpenzimi për këtë kategori përgjatë vitit 2024 është më i lartë për 284,003.06 € Shpenzimi i kategorisë buxhetore Shpenzime Kapitale për vitin 2024 është në shumë 470,563.19 € apo 67.39% nga buxheti i alokuar dhe 59.27% nga buxheti i planifikuar për këtë kategori buxhetore. Krahasuar me vitin 2023 shpenzimi për këtë kategori përgjatë vitit 2024 është më i ulët për 347,520.46 € apo 42.48% më pak. Nisur nga vlerësimi i përgjithshëm del se niveli i shpenzimit të buxhetit për këtë periudhë janar - dhjetor 2024 është në shumë prej 3,583,676.94 €. Të hyrat direkte dhe indirekte janë në shumë prej 317,125.66 €. Materialin e keni pranuar me kohë dhe nëse keni ndonjë vërejtje mund të parashtroni.

**Resul Suma** thekson:- te raporti i shpenzimeve sa është përqindja e shpenzimeve kapitale. Në faqe 27 te kodi 13142 – Akomodimi i udhëtimeve zyrtare jashtë vendit, shpenzimi nga ky kod ekonomik ka të bëjë me akomodimin e Asamblistëve në Greqi në shumë prej 5,829.00 € dhe 530.00 € akomodimi në Spanjë, 2,770.00€ akomodimi në Portugali, ndoshta është gabim teknik se ne në Greqi kemi qenë dhe kemi trajtuar kornizën afat mesme buxhetore, është mirë të përmirësohet para se me publikuar në veb faqe të komunës.

**Lindita Ballazhi** thekson:- përqindja e shpenzimeve kapitale është 67.3 %, ndërsa nëse e marrim shumën me realizim planifikim atëherë është 59.2 %. Për çështjen e kodit ekonomik në kuadër të mallrave dhe shërbimeve kodi 13142 që ka të bëjë me Akomodimi i udhëtimeve zyrtare jashtë vendit i kemi dhënë të gjitha sqarimet se çka është shpenzuar në kuadër të këtij kodi ekonomik dhe në kuadër të këtij kodi ekonomik janë këto udhëtime zyrtare të cilat janë cekur këtu është akomodimi i asamblistëve në Greqi dhe shuma është e dhënë, 530.00 € akomodimi në Spanjë jo për asamblistë por është tjetër udhëtim zyrtarë si dhe akomodimi në Portugali është tjetër udhëtim zyrtarë që s’ka të bëjë me Kuvend Komunal por shpenzimi është bërë për tri udhëtimet zyrtare nga ki kod ekonomikë.

**Kryesuesi** thekson:- është mirë që të përmirësohet para se me publikuar në vebfaqe të komunës.

**Zaim Bela** thekson:- kërkoj sqarim për shumën e përgjithshme të shpenzimeve të Unionit Evropian 446 000 € a kemi probleme me i shfrytëzuar për këtë vit. Të hyrat nga agjensioni pyjorë i Kosovës a janë prej dënimeve.

**Sherif Berisha** thekson:- te raporti i shpenzimeve për vitin 2024 shihet qartë se nga planifikimi i shpenzimeve shihet që keni realizuar 89 % , te investimet kapitale keni realizuar 59 % , ndërsa në anën tjetër keni mbi 400 000 € suficit, duke përfshirë prej 300 000 € nga donacionet dhe të hyrat dhe 100 000 € nga granti qeveritarë. Te të hyrat keni më pak realizim nga ajo që keni planifikuar. Shpenzimi i buxhetit për vitin 2024 është vetëm 89.36 % , shpenzimi i investimeve kapitale 59.27 % , realizimi i të hyrave vetanake 89.27%. Nuk ka raport se sa është shuma totale e obligimeve të papaguara deri në fund të vitit 2024. Mjete të pa shpenzuara janë në shumë prej 426,896.73 € dhe prej tyre që janë shkuar suficit janë 106, 597.58 €, ndërsa mjetet tjera në shumë prej 320, 299.15 € barten për vitin 2025. Ju kanë mbetur shumë projekte pa u realizuar si pajisja me gjenerator në qendrën kulturore “Imri Curri” në vlerë prej 5000€. Te fabrika e ujit te ujësjellësi nuk është investuar ashtu siç kanë qenë të votuara , shtëpia e Kulturës “Imir Curri” stadiumi i qytetit “Suad Brava” shpronësim në vlerë prej 19,177.65 € nga granti qeveritarë dhe 43,176.00 € nga të hyrat . Restaurimi i objekteve me trashëgimi kulturore te bunkerët, Ndërtimi i deponiisë, rregullimi i rezervarit në fshatin Seçishtë dhe shumë e shumë tjera. Kërkoj sqarim për këto projekte që nuk janë realizuar dhe për suficitin e mbetur.

**Ajnure Thaçi** thekson:- te mirëmbajtja e rrugëve lokale për vitin 2023 janë shpenzuar 38 995.40 €, ndërsa për vitin 2024 janë shpenzuar 80 175.66 € pse është kjo diferencë.

**Lindita Ballazhi** thekson:- sa i përket donacionit evropian kemi pasur disa shpenzime por për gjatë vitit 2024 nuk është shpenzuar pasi që projekti ende nuk është implementuar dhe besoj që brenda këtij viti do të implementohet dhe do të shpenzohet pjesa që ka mbetur dhe mjetet të cilat janë në buxhet barten në këtë vit. z.Sherif Berisha vetëm ka bërë një përmbledhje të raportit dhe nuk pash që ka ndonjë pyetje që më takon mua. Sa i përket suficitit granti qeveritarë është shpenzuar 96 % dhe pjesa tjetër e pa shpenzuar bartet gjatë këtij viti siç ka të bëjë me të hyrat vetanake që janë realizuar për gjatë viti 2024 bilanci i pa shpenzuar sa mjete kanë mbetur do të barten në këtë vit dhe pjesa e donacioneve. Sa i përket mirëmbajtjes së rrugëve lokale i kemi të gjitha sqarimet me kode ekonomike se çka përfshin dhe nga ky kod ekonomik janë ekzekutuar pagesa në shumë prej 53,875.68 € ndaj NPL “Pastrimi” për mirëmbajtjen e rrugëve, varrezave, kositja e parqeve, trotuareve, 5,715.00 € ndaj Europlus për zhbllokimin e kanalizimeve, pagesa prej 11,066.99 € ndaj Toni Injineri për mirëmbajtjen e ndriçimit publik dhe pagesa prej 9,518.99 € për KROSA SHPK për shenjzimin horizontal dhe vertikal të rrugëve. Sa i përket obligimeve të papaguara i kemi deklaruar në thesar faturat e papaguara dhe do tu a përgatisë me shkrim.

**Kryesuesi** thekson:- a keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka kalojmë në pikën e radhës të paraparë sipas agjendës.

### **3.Plani i punës së këshillave të fshatrave për vitin 2025.**

**Kryesuesi** thekson:- për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

**Natyra Kalisi** thekson:- plani i punës së këshillave të fshatrave është hartuar në bazë të rregullores dhe në koordinim me këshillat e fshatrave. Janë të paraparë gjashtë takime dhe nëse keni ndonjë propozim mund të parashtroni.

**Kryesuesi** thekson:- a keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka e hedh në votim;rezultati i votimit ishte njëzëri.

### **U MIRATUA PLANI I PUNËS SË KËSHILLAVE TË FSHATRAVE PËR VITIN 2025**

#### **4. Raporti i planit lokal të veprimit për barazi gjinore për vitin 2024.**

**Kryesuesi** thekson:- për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin, nëse nuk ka kalojmë në pikën e radhës të paraparë sipas agjendës.

#### **5. Raporti i mekanizmit kundër dhunës në familje në Han të Elezit.**

**Kryesuesi** thekson:- për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

**Amir Bushi** thekson:- keni pranuar raportin e mekanizmit kundër dhunës në familje në Han të Elezit, duke i plotësuar objektivat tona. Përveç materialit të cilin e kemi përcjell diçka të veçantë nuk kam.

**Kryesuesi** thekson:- a keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka kalojmë në pikën e radhës të paraparë sipas agjendës.

#### **6. Raporti i ekipit komunal për të drejtat e fëmijëve në Han të Elezit.**

**Kryesuesi** thekson:- për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

**Amir Bushi** thekson:- jemi ndër komunat e para që e kemi bërë një plan të tillë për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve dhe plani na obligonë për me bërë raport vjetorë. Materialin e keni para vetës dhe nëse keni ndonjë vërejtje apo sugjerim mund të parashtroni.

**Nora Xhoni** thekson:- pasi që jemi ndër komunat e para për hartim të këtij plani, a ka diçka më të veçantë plani.

**Amir Bushi** thekson:- në bazë të planit i kemi përcaktuar objektivat tona për zbatim për vitin 2024, 2025 dhe 2026 që do të thotë plani na obligonë që me i organizuar aktivitetet për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve.

**Hyriete Isufi** thekson:- a keni bërë ndonjë sistemim të fëmijëve për shkak se po paraqiten shumë raste me autizëm, me sindrome. A kanë pasur efekte aktivitetet të cilat i keni ndërmarr.

**Amir Bushi** thekson:- në plan shënon që komuna duhet me formuar ekipin në mënyrë që fëmijët që janë me autizëm apo me sindrome të tjera për me i integruar nëpër shkolla. Si qendër për punë sociale i ndihmojmë edhe materialisht nga qeveria që është sistem i ministrisë dhe sistemin nga qendra për punë sociale që i kanë diagnozat që i ka përcaktuar mjeku. Për fat të keq e them këtë që vitet e fundit kemi rritje të fëmijëve me autizëm që nuk ka qenë kjo dukuri më herët dhe ne merremi me trajtimin e tyre.

**Kryesuesi** thekson:- a keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka kalojmë në pikën e radhës të paraparë sipas agjendës.

## 7. Informatë mbi veprimtarit e subjekteve afariste për vitin 2024.

**Kryesuesi** thekson:- për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

**Majlinda Kaloshi** thekson:- Drejtorja për Zhvillim Ekonomik dhe Turizëm është përgjegjëse për subjektet që ushtrojnë veprimtari biznesore në territorin e Hanit të Elezit, mbajtjen e statistikave rreth tyre, krijimin e kushteve për zhvillim ekonomik lokal përmes strategjive të ndryshme sektoriale, promovim të komunës dhe kushte për zhvillim të qëndrueshëm duke qenë urë bashkëpunimi në mes ministrive, organizatave, donatorëve të huaj dhe Komunës së Hanit të Elezit për vitin 2024. Drejtorja në kuadër të saj ka edhe Qendrën për Regjistrim të Bizneseve e cila kryen të gjitha shërbimet sa i përket bizneseve lokale. Sipas statistikave që drejtorja ka, në Qendrën për Regjistrim të Qytetarëve që nga fillimet e saj e deri më tani janë të regjistruar 391 biznese, nga ku: 234 prej tyre i takojnë atyre Individuale (B.I), 156 biznese SHPK dhe 1 biznes SHA. Për vitin 2024 te ne figurojnë rreth 35 biznese të cilat në formë tabelare i kemi të paraqitura në bazë të kategorizimit llojit dhe gjinisë. Te sektori i taksave janë të paraqitura edhe insektimet që janë bërë gjatë vitit 2024 , gjobat, aktvendimet , Faturimi, Inkasimi. Gjatë vitit 2024 kemi inkasuar 77,591.88 €.

**Resul Suma** thekson:- faqe gjashtë janë dy tabela dhe dy shifra të ndryshme , njëra është 77,591.88 €, ndërsa më lart është 76,589.88 €, kërkoj sqarim.

**Sherif Berisha** thekson:- është me plan zhvillimorë komunal të riun apo të vjetrin është shumë me rëndësi me na njoftuar.

**Majlinda Kaloshi** thekson:-vlera e saktë është ajo që është paraqitur në mënyrë tabelare.

**Zaim Bela** thekson:- sa është borxhi total ndër vite që kanë ndërmarrjet.

**Majlinda Kaloshi** thekson:- e kemi si vlerë totale dhe do tua përcjelli me shkrim.

**Kryesuesi** thekson:- a keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka kalojmë në pikën e radhës të paraparë sipas agjendës.

## 8.Të ndryshme.

**Kryesuesi** thekson:- për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

**Sherif Berisha** thekson:- a ka pasur auditim te kompania pastrimi për të hyrat dhe shpenzimet. Mjekët të cilët vijnë te shëndetësia dhe qytetarët nuk po janë të njoftuar dhe të gjithë ato termine të cilat bëhen në fund shërbim nuk ju kryhet për shkak se mjekja apo mjeku ik prej atyhit nuk rrinë. Shqetësimi imë ku isha edhe unë prezentë që mjeku paraprak nuk e liron dhomën ku duhet të vendoset mjekja tjetër për shërbim të qytetarëve. Mbajtja e rendit atje nuk është e mirë sepse vjen një teknike e QKMF-së dhe hynë pa renë dhe e pyesë që pse po hynë pa rendë dhe më përgjigjet që unë punojë këtu dhe unë i them që duhesh me majtë rendë sepse ishin nënat tona , baballarët tonë por në fund nuk kanë marr shërbim tre apo katër persona sepse mjekja shkojë dhe askush nuk jep përgjegjësi. Ankesa kam pasur edhe më herët për mjekun në fjalë.

**Sevdi Dernjani** thekson:- sa i përket auditimit pyetjen do ta adresojmë direkt te përfaqësuesit e kompanisë pastrimi. Me që drejtoresha e shëndetësisë nuk është prezente sepse është në pushim por shqetësimet të cilat i keni paraqitur do të ja adresojmë drejtoreshës së shëndetësisë.

**Refet Kalisi** thekson:- auditim nuk ka pasur dhe është mirë me u bërë një auditim në kompani sepse nuk kemi pasur asnjë herë dhe është në të mirë e kompanisë për shkak se mundet me u bërë ndonjë gabim dhe përmirësohen.

**Kryesuesi** thekson:- sa i përket shqetësimeve të shëndetësi është e vërtetë sepse ka ankesa prej qytetarëve për shkak se aty nuk është ka mbahet rend në QKMF. Shqetësimet janë të vazhdueshme dhe masa nuk merr askush. Kërkoj nga drejtoresha që ta viziton më shpesh QKMF-në për shkak se qytetarit nuk po i kryhet shërbimi siç parashihet me orar dhe në bazë të rregullores së QKMF-së.

**Resul Suma** thekson:- në shëndetësi ka probleme dhe janë gjëra që shihen. Falënderoj pumologën që ka ardhur falas me bërë vizita këtu në Han të Elezit. Mjeku problematikë që drejtoresha dhe drejtori i QKMF-së e dinë dhe është mirë me marr masa për shkak se problemin nuk mendojë që e ka shkaktuar specialistja apo motra. Termin kam pasur edhe unë në ora gjashtë dhe ka hyrë në ora shtatë. Drejtoresha duhet më shpesh me vizituar QKMF-në dhe mi adresuar problemet tona për shkak se nuk janë probleme të miat e as të z.Sherif Berisha por janë probleme të qytetarëve.

**Kryesuesi** thekson:- a keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka shpalli të mbyllur mbledhjen.

Ju faleminderit për pjesëmarrje.

Mbledhja përfundoi në ora 11:45.

**Procesmbajtësi**  
**Avni Bushi**



**Kryesuesi i Kuvendit**  
**Florim Shkreta**

